

Në bazë të nenit 16 paragrafi (1) alineja 1, ndërsa në lidhje me nenin 3 paragrafi (1) pika 5 dhe neni 18, të gjithë nga Ligjin për shoqata dhe fondacione (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 52/2010, 135/2011 dhe 55/2016), dhe në pajtim me memorandumun e nënshkruar për bashkëpunim ndërmjet Shoqatës Ekologjike të Maqedonisë nga Shkupi, Qendrës për edukim dhe zhvillim nga Tearca, Klubit bjeshkatar Luboten nga Tetova dhe Iniciativës për integritet qytetar nga Gostivari, formohet platforma “Miqtë e Sharrit” e cila paraqet asociacion joformal të shoqatave të pavarura të qytetarëve dhe individuale. Platforma, në Kuvendin themelues që u mbajt më 27.02.2020 e miratoi këtë:

## **S t a t u t**

### **të Platformës “Miqtë e Sharrit”**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

Me këtë statut përcaktohet: emri, selia, qëllimet dhe aktivitetet, strukturimi organizativ, funksionimi si dhe financimi i platformës “Miqtë e Sharrit” në tekstin e mëtejme Platforma.

##### **Neni 2**

(1) **Platforma është e themeluar nga:** Shoqëria ekologjike maqedonase (MED), Qendra për edukim dhe zhvillim (CED), Klubi bjeshkatar “Luboten” dhe Iniciativa për integritet qytetar, Gostivar (IIQ), bashkim i të cilave është jopartiak, joqeveritar dhe vullnetar joprofitabil, në kohë të papërcaktuar dhe në bazë të barabartë.

(2) **Emri i Platformës është: “Miqtë e Sharrit”.**

(3) **Zyra informative – selia e platformës** gjendet në zyrat e Qendrës për edukim dhe zhvillim (CED) në Tearcë, ndërtesa e vjetër shkollore 1224 Tearcë

##### **Neni 3**

(1) **“Miqtë e Sharrit”** në publik gjithmonë do të veprojnë në mënyrë të bashkuar me logon e tyre (me motiv kaltër-gjelbër të Malit Sharr nën të cilin qëndron teksti: IIIapa-Sharri) si dhe misioni e vizioni i Platformës.

(2) Anëtarët e “Miqtë e Sharrit” mund ta promovojnë idenë dhe misionin e kësaj Platforme në ngjarje publike, por gjithmonë me materiale promovues të përcaktuara

paraparakisht dhe me konsultim paraprak të anëtarëve tjerë dhe personit të caktuar për marrëdhënie me publikun në kuadër të kësaj platforme.

## **QËLLIME DHE DETYRA TË PLATFORMËS**

### **Neni 4**

(1) **Qëllimi** i platformës është promovim dhe përkrahje e iniciativës për të shpallur Malin Sharr park nacional, përkatësisht për të ruajtur natyrën e Malit Sharr dhe përdorim i drejtë i resurseve natyrore.

(2) Kjo platformë nuk ka për qëllim zhvillim të interesave vetjake ekonomike. Të gjitha mjetet financiare janë të dedikuara vetëm për plotësimin e qëllimeve të statutit.

### **Neni 5**

#### **(1) Detyrat e platformës janë me sa vijon:**

- a) ta përkrah procesin e shpalljes së Malit Sharr për park nacional,
- b) ta përkrah punën e parkut nacional të ardhshëm në realizimin e detyrave në fushën e ruajtjes së natyrës, edukimit për mjedisin jetësor, aktivitete me turizëm rural dhe forma tjera alternative të turizmit, marrëdhënie me publikun si dhe rreth organizimit të aktiviteteve rekreative, të hulumtojë dhe dokumentojë,
- c) ta ngrit vetëdijen publike për përfitimet që mund t'i ketë popullata lokale nga shpallja e Malit Sharr për park nacional,
- d) të lidh Malin Sharr me rrjetin rajonal ekologjik dhe
- e) ta përmirësojë bashkëpunimin me zona tjera të mëdha të mbrojtura, faktorët për ruajtjen e natyrës, rrjetet e organizatave dhe shoqatat brenda dhe jashtë vendit me veprimtari të ngjashme

(2) Detyrat kanë të bëjnë me organizim të ngjarjeve publike, kulturore dhe shkencore të cilat ndërlidhen me mbrojtjen e mjedisit jetësor, zonat, natyrën dhe mbrojtjen e llojeve nëpërmjet dhënies së këshillave profesionale, zhvillim të turizmit dhe zhvillim rural, përkrahje logjistike të ngjarjeve në lidhje me edukimin për mjedisin jetësor, këshilla praktike për masa për ruajtje të natyrës si dhe përgatitje dhe shpërndarje të materialeve edukative dhe publikime nga puna e Platformës.

## ANËTARËSIMI

### Neni 6

(1) Persona fizikë dhe persona juridikë si dhe organizata dhe asociacione qytetare nga Maqedonia dhe nga jashtë mund të bëhen anëtare të barabarta të platformës për s kohë që kjo është në pajtim me plotësimin e qëllimit primar të platformës.

(2) Personat juridikë – të vendit ose të huaj, si dhe organizatat qytetare të regjistruara në pajtim me Ligjin për shoqatat dhe fondacionet të cilat dëshirojnë t'i bashkëngjiten platformës duhet t'i plotësojnë **kriteret në vijim:**

- të jenë të regjistruar dhe të punojnë në komunat të cilat gjenden në territorin e Malit Sharr.

- të kenë së paku 3 (tre) vite përvojë pune në zbatimin e projekteve për mbrojtjen e natyrës në Republikën e Maqedonisë së Veriut apo në shtetin ku janë të regjistruar.

- t'i kenë plotësuar obligimet e tyre dhe të mos kenë ndërmarrë aktivitete në kundërshtim me parimet e transparencës ndërsa në pajtim me nenet 10, 11, 16, 18 dhe 23 të Ligjit për shoqata dhe fondacione.

- së paku dy persona të punësuar në organizatë të jenë në marrëdhënie të përhershme të punës.

- listë aktive e anëtarëve-vullnetarë.

- përvojë në organizim të ngjarjeve publike gjatë punës së tyre.

- raporte të publikuara dhe prezantuara në mënyrë publike dhe transparente për punën financiare të organizatës në tre vitet e fundit.

- kanë edhe kapacitet teknik dhe njerëzor për zbatim të projekteve të përbashkëta.

- vendimet për punën e tyre t'i kenë sjell në pajtim me nenin 11 të Ligjit për shoqata dhe fondacione.

- nuk ekziston konflikt interesash me aktivitetet paraprake të cilat i ka zbatuar personi i cili anëtarësohet, përkatësisht të njëjtat nuk e cenojnë rendin publik dhe Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## **MËNYRË E VENDIMARRJES PËR ANËTARËSIM, PËRJASHTIM DHE ANËTARËSI NË SHOQATËN**

### **Neni 8**

- (1) Pranimi i anëtarëve do të bëhet me kërkesë me shkrim (fletë-anëtarësim) e cila do të parashtrohet në zyrën e platformës “Miqte e Sharrit”.
- (2) Këshilli drejtues pas pranimi të kërkesës me shkrim për anëtarësim në platformën, do të konvokojë mbledhje në të cilën do të vendos nëse personat juridik – vendas apo të huaj, si dhe organizatat qytetare të regjistruara në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione i plotësojnë kriteret për anëtarësim në platformë.
- (3) Nëse në mbledhjen, Këshilli drejtues konstaton që janë plotësuar kriteret për anëtarësim në platformën, për atë me shkrim e njofton anëtarin e ri.
- (4) Këshilli drejtues ka të drejtë të refuzojë kërkesë për anëtarësim, nëse vlerëson që anëtari i cili anëtarësohet do ta cenojë reputacionin dhe veprën e platformës.
- (5) Për vendimin e këtillë, me shkrim do ta njoftojë anëtarin i cili anëtarësohet, pa arsyetim të shkaqeve për vendimin.

### **Neni 9**

- (1) Pasi të jetë miratuar vendimi në mbledhje të Këshillit drejtues për pranim të anëtarit të ri, personi juridik apo organizata qytetare anëtarësohet në platformën me të drejta dhe obligime të kufizuara.
- (2) Anëtari i ri fiton status të anëtarit të ri platformës pas 3 (tre) viteve nga pranimi, nëse në atë periudhë në mënyrë aktive ka marrë pjesë me gjithë kapacitetin e vet në aktivitetet dhe projektet e përbashkëta të platformës.
- (3) Këshilli drejtues bën kontroll mbi punën e anëtarëve të ri edhe pas skadimit të periudhës për kontroll, në mbledhje do të sjell vendim nëse anëtari i ri i ka plotësuar të gjitha kriteret për të fituar anëtarësi me të drejta të plota në Platformën.
- (4) Këshilli drejtues e mban të drejtën, në qoftë se anëtari i ri në periudhën për kontrollim nuk i ka plotësuar obligimet edhe më herë ta përjashtojë nga anëtarësia ndërsa me qëllim të mos e cenojë imazhin, qëllimin dhe detyrat e platformës.
- (5) Para se të përjashtohet, anëtari i ri ka të drejtë në formë të shkruar apo me gojë t'i prezantojë të dhënat e tij para Këshillit drejtues.
- (6) Anëtari i ri fiton të drejtën për votë pas vendimit të miratuar të Këshillit drejtues për kushte të plotësuara për pranim të anëtarit të përhershëm të Platformës.

## **TË DREJTA DHE OBLIGIME TË ANËTARËVE TË RI**

### **Neni 10**

#### **(1) Anëtari i ri i Platformës i ka të drejtat në vijim:**

- edukim i përhershëm për punën e platformës,
- rrjetëzim me anëtarët e Platformës dhe mundësi për aktivitete të përbashkëta dhe bashkëpunim,
- zbatim të aktiviteteve në suaza të platformës, nën mbikëqyrje të Këshillit drejtues të Platformës dhe
- pjesëmarrje në procesin e lobimit.

#### **(2) Anëtari i ri i Platformës i ka obligimet në vijim.**

- t'i respektojë qëllimet dhe detyrat e platformës dhe në punën e vet çdoherë të nisët nga ato,
- në projektet e përbashkëta të marr pjesë me kapacitetin e tij teknik dhe njerëzor për nevojat e të njëjtave,
- me kohë dhe si nikoqir i mirë t'i zbatojë aktivitetet dhe projektet e ndara në kornizën e përcaktuar kohore,
- në bazë periodike të parashtrijë raporte në Këshillin drejtues për aktivitetet e zbatuara,
- me kohë të kërkojë asistencë teknike dhe njerëzore për nevojat e aktiviteteve të ndara dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta dhe
- të mos veprojë në kundërshtim me Statutin, Rregulloren dhe Programin e Platformës si dhe në kundërshtim me Kushtetutën, Ligjet dhe Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.

## **TË DREJTA DHE OBLIGIME TË ANËTARËVE TË PËRHERSHËM**

### **Neni 11**

#### **(1) Të drejtat e anëtarëve të përhershëm të Platformës janë këto:**

- të marrin pjesë në aktivitetet rrjedhëse të Platformës,
- bashkërisht apo në mënyrë të pavarur të zbatojnë projekte në të njëjtën,

- të vepron në publik për qëllimet dhe detyrat e platformës,
- të marrin pjesë në sjelljen e vendimeve për punën rrjedhëse të platformës dhe
- të jenë të zgjedhur për anëtarë të ri në Këshillin drejtues të Platformës.

**(2) Obligimet e anëtarëve të përhershëm të Platformës janë këto:**

- t'i respektojnë qëllimet dhe detyrat e Platformës dhe në punën e tyre gjithmonë të nisen prej tyre,
- në projektet e përbashkëta të merr pjesë me kapacitetin e tij teknik dhe njerëzor për nevojat e të njëjtave,
- me kohë dhe si nikoqir i mirë t'i zbatojë aktivitetet dhe projektet e ndara në kornizën e përcaktuar kohore,
- në bazë periodike të parashtrijë raporte në Këshillin drejtues për aktivitetet e zbatuara,
- me kohë të kërkojë asistencë teknike dhe njerëzore për nevojat e aktiviteteve të ndara dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta dhe
- të mos vepron në kundërshtim me Statutin, Rregulloren dhe Programin e Platformës si dhe në kundërshtim me Kushtetutën, Ligjet dhe Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.

(3) Nëse anëtari ekzistues nuk i realizon obligimet e veta gjatë plotësimit të aktiviteteve të përbashkëta apo projekteve në Platformën, Këshilli drejtues ka të drejtë me paralajmërim me shkrim t'i sugjerojë anëtarit ekzistues për parregullsitë në punë dhe t'i jep afat në të cilin të njëjtat duhet t'i mënjanojë dhe të veprojë sipas udhëzimit.

(4) Pas afatit të caktuar kohor me shkrim, anëtari i përhershëm ka për obligim në Këshillin drejtues të parashtrijë raport për aktivitetet e ndërmarra sipas paralajmërimit.

(5) Nëse Këshilli drejtues vendos që anëtari nuk ka vepruar në pajtim me paralajmërimin me shkrim dhe udhëzimet nga i njëjti, ka të drejtë ta përjashtojë anëtarin nga aktivitetet dhe projektet të cilat zbatohen në platformë, si dhe nga aktiviteti dhe projekti të cilin ai anëtar e ka zbatuar në momentin për konstatim të parregullsive në punën dhe të caktojë anëtar tjetër të përhershëm i cili do ta merr përsipër punën në projektin apo aktivitetin për shkak të zhvillimit dhe plotësimit të papenguar të qëllimeve dhe detyrave të platformës.

**Neni 12**

(1) Anëtarët duhet të përpiqen për të plotësuar qëllimet e Platformës dhe detyrat në suaza të platformës.

(2) Personat fizik mund të shpërblehen me titull anëtarë nderi, me vendim të anëtarëve – themelues të Platformës.

(3) Të gjithë anëtarët e përhershëm të Platformës janë të barabartë.

(4) Të gjithë anëtarët kanë të drejtë në mënyrë të barabartë me anëtarët tjerë të marrin pjesë në realizimin e qëllimeve të Platformës të jenë me kohë dhe plotësisht të informuar për punën dhe aktivitetet e Platformës.

(5) Çdo person juridik dhe fizik, si dhe grup joformal që është ANËTAR I PËRHERSHËM i Platformës ka një votë gjatë vendimmarrjes në organet e Platformës.

## **STRUKTURË ORGANIZATIVE**

### **Neni 13**

**(1) Organet e Platformës janë:**

- Kuvendi i përgjithshëm
- Këshilli drejtues dhe
- Kryetari.

## **KUVENDI I PËRGJITHSHËM**

### **Neni 14**

(1) Kuvendi i përgjithshëm është organi më i lartë i Platformës që i përfshin të anëtarët e Platformës.

(2) Një herë në vjet organizohet takim i anëtarëve në të cilin miratohen vendime përkatëse për veprimin vjetor të Platformës.

(3) Propozimet e anëtarëve duhet të dërgohen më së voni një javë para mbajtjes së kuvendit të përgjithshëm deri tek anëtarët themelues në formë të shkruar.

(4) Kuvendi i Përgjithshëm mund të sjell vendime pa marrë parasysh numrin e anëtarëve të pranishëm.

(5) Sipas nevojës mund të konvokojë edhe Kuvend të Përgjithshëm të jashtëzakonshëm.

**(6) Kompetencat e Kuvendit të Përgjithshëm janë si vijon:**

a) Përkufizim i aktiviteteve vjetore dhe raportet financiare të prezantuara nga Këshilli drejtues.

b) Votim dhe miratim i raportit vjetor financiar për punën e Platformës.

- c) Miratim të vendimeve për ndryshim të statutit apo për shpërbërje të Platformës.
- d) Vendime tjera të nevojshme për funksionim normal të Platformës dhe zbatim të qëllimeve dhe detyrave të saj.
- (e) Detyra tjera në lidhje me statutin dhe qëllimet e Platformës.
- (7) Mbledhjet e Kuvendit të përgjithshëm janë të mbyllura dhe të drejtë për të marrë pjesë kanë vetëm anëtarët e platformës.
- (8) Vendimet e Kuvendit të Përgjithshëm miratohen me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm.
- (9) Vendimi për ndryshim të Statutit apo për shpërbërje të Platformës miratohet me 2/3 e shumicës nga të gjithë anëtarët.

## **KËSHILLI DREJTUES**

### **Neni 15**

- (1) Këshilli drejtues është organ ekzekutiv dhe operativ i Platformës dhe e përbëjnë 5 anëtarë të përhershëm.
- (2) Anëtarët e Këshillit i zgjedh Kuvendi me mandat prej dy viteve, me mundësi për zgjedhje të sërishme, me ç'rast në këtë Këshill anëtarë janë më së shumti dy anëtarë nga e njëjta shoqatë që është anëtare e Platformës.
- (3) Këshilli mban takime sipas nevojave, ndërsa së paku një herë në tre muaj.
- (4) Këshilli mund të mbajë edhe mbledhje elektronike (virtuale) nëse për të ekziston nevojë urgjente.

### **Neni 16**

#### **Kompetencat e Këshillit drejtues janë këto:**

1. E zbaton Statutin dhe aktet tjera të Platformës;
2. I zbaton vendimet e Kuvendit të Platformës;
3. E zbaton programin për punë të Platformës;
4. Propozon ndryshime të Statutit dhe akteve tjera të Platformës;
5. Propozon program për punë, plan financiar dhe dokumente tjera të Platformës;
6. Propozon raporte financiare dhe tjera për punën e Platformës;
7. Menaxhon me pronën e Platformës në pajtim me autorizimet nga Kuvendi, me Statutin dhe me dispozitat ligjore në Republikën e Maqedonisë;



8. Punon për grumbullim të mjeteve për Platformën;
9. Shpërndan mjete në Platformë në pajtim me programin për punë të Asociacionit dhe me planin e miratuar financiar;
10. Themelon grupe permanente dhe të përkohshme punuese;
11. Realizon edhe punë tjera të besuara nga Kuvendi ose punë që me dispozita tjera i janë dhënë nën kompetencë.
12. Vendos për pranim të anëtarëve të ri në platformë,
13. Zbaton mbikëqyrje të punës së anëtarëve të ri dhe atyre ekzistues të Platformës.
14. Vendos për përjashtim të anëtarëve të ri dhe atyre ekzistues nga platforma dhe
15. Vendos për t'ua marrë aktivitetet dhe projektet e ndara për punë anëtarëve të ri dhe ekzistues të platformës si dhe për të emëruar anëtarin i cili do ta merr përsipër punën mbi të njëjtat.

### **Neni 17**

- (1) Anëtarët e Këshillit drejtues nuk pranojnë kompensim për punën e tyre në këtë Këshill.
- (2) Anëtarëve të Këshillit drejtues mund t'u mbulohen shpenzimet për udhëtime dhe shpenzimet tjera në lidhje me punën e tyre.

## **KRYETAR DHE RAPORTUES I PLATFORMËS**

### **Neni 18**

- (1) Anëtarët e Këshillit drejtues nga radhët e anëtarëve të tyre zgjedhin Kryetar të Platformës me mandat prej dy viteve.
- (2) Kryetari e përfaqëson platformën dhe kujdeset për punën e saj.
- (3) Kryetari gjatë punës së vet duhet të veprojë si palë neutrale dhe të kujdeset për rrjedhën e punës dhe aktivitetet e Platformës, përkatësisht nuk guxon të ekzistojë konflikt i interesave personale ndërmjet atyre të platformës dhe interesat të cilat i përfaqëson organizata nga e cila vjen.
- (4) Kryetari ka për obligim ta monitorojë dhe ta ndihmojë realizimin e projekteve të cilat janë në zhvillim e sipër.
- (5) Kryetari i konvokon dhe kryeson me mbledhjet e Këshillit të drejtues dhe të Kuvendit të përgjithshëm.
- (6) Kryetari i nënshkruan vendimet e miratuara në mbledhjet e Këshillit drejtues dhe të Kuvendit të përgjithshëm.

(7) Në rast të mungesës së Kryetarit, obligimet i ndërmerr nënkryetari ose anëtar tjetër i caktuar nga Kryetari e me qëllim të zhvillimit të papenguar të punëve rrjedhëse.

(8) Kryetari është kompetent për parashtrim të raportit përfundimtar vjetor dhe raportet financiare në Kuvendin e përgjithshëm.

(9) Kryetari përcakton anëtar-raportues nga radhët e anëtarëve ekzistues të platformës.

(10) Raportuesi ka për obligim ta monitorojë punën dhe aktivitetet si dhe projektet e platformave të anëtarëve të ri dhe atyre anëtarëve ekzistues dhe për të njëjtë ta informojë Këshillin drejtues.

(11) Raportuesi ka për obligim t'ia paraqesë Këshillit drejtues të gjitha parregullsitë në punën e anëtarëve ekzistues dhe atyre të përkohshëm në afat sa më të shkurtë nga momenti i zbulimit të fakteve për ato parregullsi.

## **FITIMI DHE MENAXHIM ME MJETE**

### **Neni 16**

(1) Platforma ka buxhet të vet dhe me të njëjtin menaxhon në pajtim me qëllimet dhe nevojat për realizim të projekteve dhe aktiviteteve.

(2) Anëtarët nuk pranojnë honorarë nga platforma. Askush nuk duhet të ketë dobi personale nga shpenzimet të cilat kanë të bëjnë me qëllimet e kësaj platforme.

(1) (3) Të gjitha aktivitetet të cilat i zbatojnë anëtarët e kësaj platforme janë pa kompensim financiar. Megjithatë, shpenzimet që bëhen në kuadër të aktiviteteve nga ana e anëtarëve, e në kuadër të plotësimit të qëllimit të platformës, mund të rimbursohen në pajtim me dispozitat për shpenzime rrugore dhe mëditje në vend.

## **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 20**

(1) Çdo aktivitet kryhet në baza të vullnetit të mirë dhe me vullnetarizëm pa pranim të honorarëve.

### **Neni 21**

(1) Anëtar i Platformës mund të jetë person me 18 vite të mbushura.

(2) Anëtarët kanë të drejtë në një votë gjatë vendimmarrjes në Kuvendin e përgjithshëm.

(3) Të gjitha të drejtat dhe obligimet të cilat rezultojnë nga anëtarësia dhe funksionet e zgjedhura kryhen personalisht. Pas ndërprerjes së anëtarësisë në Platformë, automatikisht ndërpriten edhe të gjitha anëtarësitë në organet e Platformës.

(3) Të gjitha fletëvotimet do të hapen, përveç nëse së paku një e treta e anëtarëve të pranishëm të Kuvendit kërkojnë votimi të jetë i fshehtë.

- (4) Fletat të cilat shfaqin përmbajtje do të trajtohen si të pavlefshme.
- (5) Të gjitha vendimet miratohen me shumicë të thjeshtë, përveç nëse me statut është përcaktuar ndryshe.
- (6) Anëtari përzgjidhet nëse fiton shumicë të votave në rrethin e parë.
- (7) Për ndryshimet dhe plotësimet e statutit, nevojitet shumicë e dy të tretave të votave të vlefshme, që i njëjti të konsiderohet se është miratuar.
- (8) Vendimet e miratuara nga organet e Platformës dokumentohen në formë të shkruar dhe nënshkruhen nga kryetari i kuvendit.
- (9) Nëse gjatë Kuvendit të përgjithshëm anëtarët votojnë për propozimin për mosbesim në lidhje me ndonjë bartës të funksionit në zyrë, me shumicë nga votat e vlefshme të anëtarëve të pranishëm, bartësi i funksionit duhet doemos të jep dorëheqje. Bartësi i funksionit i cili është i revokuar ka të drejtë të prononcohet në Kuvendin e përgjithshëm para votimit.

## **LIKUIDIMI I PLATFORMËS**

### **Neni 22**

- (1) Vetëm Kuvend i përgjithshëm i jashtëzakonshëm i konvokuar enkas për këtë qëllim mund të sjell vendim për likuidim të platformës me votim për likuidim nga tre e katërta e anëtarëve të pranishëm.
- (2) Në rast të likuidimit të Platformës të gjitha mjetet do të shpërndahen në mënyrë të barabartë dhe do të transferohen në llogaritë e anëtarëve ekzistues të Platformës apo të personave të tretë të përcaktuar me konsensus.

## **DISPOZITË PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 23**

Statuti hyn në fuqi pas konstituimit të Kuvendit më 27.02.2020

**KRYETAR,**  
Metin Muaremi

